



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Shefki Abdullahu, U.d Drejtor Ekzekutiv në AME	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Malishevës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Datë: 27.03.2026 -VI-020-220
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmerisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmerisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për AME	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Drejtor,


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar vendimin nr.02/80, për miratimin e raportit të komisionit komunal për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në komunën e Malishevës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmerisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmerisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr.02/80, për miratimin e raportit të komisionit komunal për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në komunën e Malishevës.

I miratuar më datë: 12.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.03.2026



PRANUAR MË: 19/03/2026  
ACCEPTED ON:

PRILMJEHO: 02/80



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

HYRJE - INCOMING		
REPUBLIC OF KOSOVO - MALISHEVE MUNICIPALITY		
REPUBLIKA E KOSOVËS - MALISHEVË KOMUNË		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration		
Data Date:	23.03.2026	
Spesie organizative	Nr. i Lendes	Vlera
-41-	020-220	

Kryesuesi i Kuvendit  
Nr.02/  
Datë: 12.03.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 neni 40 paragrafi 2 shkronja (e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", Ligjit nr.04/L-027, për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, neni 37 dhe neni 43, Rregulloren e QRK-së, nr.17/215, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, neni 12 par.12.1 pika 1.6 dhe Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023,

*Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë, 30.05.2023 merr këtë:*

VENDIM

MIRATOHET RAPORTI I KOMISIONIT KOMUNALE PËR VLERËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATËKEQËSITË NATYRORE ELEMENTARE NË KOMUNËN E MALISHEVËS

1. Miratohet, raporti nr.01/449, dt.03.03.2026, i përgatitur nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në lidhje me vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore/ elementare në bujqësi, në Komunën e Malishevës.
2. Raporti do të procedohet konform Rregullos e QRK-së, nr.17/215, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i cili përfshinë vlerësimin financiare të dëmeve në shumën prej 540,523.00 €.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes organeve kompetente të autorizuar me ligj, ndërsa pjesë e këtij vendimi është edhe raporti përmbledhës i komisionit cili mban referencën nr.01/449, dt.03.03.2026.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008" konkretisht Rregulloren ( QRK )nr.03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, neni 9 dhe akteve tjera nënligjore që e rregullojnë këtë qështje juridiko administrative.

Vendimi ju dërgohet :  
1.MAPL-së  
2.Arkivit të Komunës





PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 03/03/2026  
PRIMJENJO:  
Nr. No. Br. 01/449



## Republika e Kosovës KOMUNA E MALISHEVË

### KOMISIONI KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËVE NGA FNFT

PËR:	z. Fatmir ADEMAJ, Kryesues i Kuvendit të Komunës
PËRMES:	z. Ekrem KASTRATI, Kryetar i Komunës
NGA:	Halit MAZREKU, Sekretar i Komisionit <i>[Signature]</i>
LËNDA:	<b>RAPORT:</b> mbi vlerësimin e dëmeve nga FNFT,-

I nderuar !

Bazuar në situatën e krijuar si pasojë e reshjeve atmosferike me intenzitet të lartë që nga orët e mërkurës së datës 05.01.2026, duke rrezikuar përmbajtje të zonave përgjatë pellgut të lumit Mirusha, dhe rreziku i qarjes së digës në liqenin e Mirushës, me kërkesë të Komandantit të Incidentit dhe Sektorit të Emergjencave, kryetari i Komunës me vendim Nr.01/04, të datës 06.01.2026 ka aktivizuar Shtabin Emergjent Komunal për menaxhimin e Situatës Emergjente - Vërshime.

Shtabi Emergjent Komunal ka menaxhuar Situatën Emergjente-Vërshimet në përputhshëri me aktet ligjore dhe Planet Emergjente për komunën e Malishevës.

Pas përfundimit të Situatës Emergjente, me propozimin e Sektorit të Emergjencave - DKMSH, kryetari i komunës, duke u bazuar në Nenin 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga FNFT dhe Nenit 9 pika 2 dhe 3 të Rregullorës (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga TNFT, me aktvendim Nr.01/27, të datës, 09.01.2026, ka themeluar Komisionin komunal për VD nga FNFT me mandat katër (4) vjeçar.

Më datë 12.01.2026, Sektori i Emergjencave - DKMSH, ka bërë shpallje publike për afatin e lajmërimit të dëmeve të shkatuara si pasojë e vërshimeve për Ekonomi Familjare, Bujqësi, Biznese dhe Infrastrukturë publike dhe private, me afat deri më 22.01.2026.

Pas përfundimit të afatit, Komisioni ka tërhequr nga zyra komunale për pritje gjithësej: 235 aplikacione, dhe atë për dëmet e shkatuara në:

- Bujqësi,
- Ekonomi familjare,
- Biznese, dhe
- Infrastrukturë publike dhe private.

Prej datës 23.01. deri më 12.02.2026, Komisioni ka bërë vlerësimin e dëmeve në terren. Pas përfundimit të punës në vlerësimin e dëmeve në terren sipas kërkesave, Komisioni ka filluar me klasifikimin e kërkesave dhe përpilimin e formularëve të vlerësimit. Komisioni ka trajtuar të gjitha kërkesat e parashtruara në vendin e shkaktimit të dëmit, dhe pas plotësimit të formularëve konstaton se:

- 57 kërkesa nuk përkojnë me Situatën Emegjente të vërshimit dhe se Komisioni nuk ka mundur të konstatoj dëme, dhe se si të tilla janë rrefuzuar.

Ndërsa, dëmet e shkatuara llogariten të jenë: 540,523.00 €

Nr.	Përshkrimi	Nr. i kërkesave	Vlera e dëmit
1	Dëmet e shkatuara në Ekonomi Familjare	122	211,884.00 €
2	Dëmet e shkatuara në Bujqësi	14	8,260.00 €
3	Dëmet e shkatuara në Biznese	32	109,879.00 €
4	Dëmet e shkatuara në Infrastruktur Publike	10	210,500.00 €
<b>VLERA TOTALE E DËMEVE :</b>			<b>540,523.00 €</b>

1. Bajram SHABANAJ, Kryetar
2. Remzi PAÇARIZI, Anëtar
3. Ramiz HOXHA, Anëtar
4. Kushtrim KRASNIQI, Anëtar
5. Halit MAZREKU, Sekretar

Me nderimet

## Donjeta Cakolli

---

**From:** Donjeta Cakolli  
**Sent:** Friday, March 27, 2026 1:53 PM  
**To:** Muharrem Morina; Fatmir Ademaj  
**Subject:** FW: Vendimet e KK Malishevë  
**Attachments:** 020-220-2026.pdf; 020-711-2-2023.pdf; 020-202-13-2024.pdf; 020-326-42-2025.pdf

Te nderuar,

Ju lutem te bëni përmirësimin e vendimit me nr. 02/80 pasi qe ne vendim thuhet se vendimi është marr ne seancën e datës 30.05.2023.